V E N D I M
Nr. 209, datë 16.5.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 602, DATË 17.11.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E DHËNIES ME KONCESION TË DISA OBJEKTEVE TË INDUSTRISË SË BAKRIT DHE TË KROMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D OS I:

Në vendimin nr. 602, datë 17.11.2000 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3.1, me këtë përmbajtje:

"3.1. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj kontrate.".

2. Pika 5 ndryshon si më poshtë vijon:

"5. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko